

URDHËR
Nr.5591, datë 5.8.2011

PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT DISIPLINOR TË PËRMBARUESVE GJYQËSORË
PRIVATË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 1 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar si dhe nenit 51 të ligjit nr.10 031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Krijimin e Komisionit Disiplinor të Përmbarruesve Gjyqësorë Privatë me përbërje si më poshtë vijon:

-Zoti Petrit Qarri, Kryetar i Dhomës Kombëtare të Përmbarruesve Gjyqësorë Privatë në cilësinë e kryetarit.

- Z.Astrit Kaptelli, Kryetar i Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Përmbarruesve Gjyqësorë Privatë, në cilësinë e anëtarit.

- Z.Shaqir Hasani, avokat në cilësinë e anëtarit.

2. Komisioni Disiplinor i Përmbarruesve Gjyqësorë Privatë organizohet dhe funksionon sipas rregullave të miratuara me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi